



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:289098  
Datë: 09.08.2024  
Numri i dokumentit: 06036542

**Kom.Dh.Shk.II.nr.199/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë**, gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare - Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, sipas autorizimit e përfaqëson A.S., zyrtar ligjor, kundër debitorëve: 1. N.T.SH. “Magic Park”, me seli në Prishtinë, me autorizimi e përfaqëson Arlind Jupolli avokat nga Prishtina, 2. F.G. nga Prishtina dhe 3. F.G.1. nga Prishtina, me objekt përmbarimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.786/2023 të datës 21.11.2023, me datën 08.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit N.T.SH. “Magic Park”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.786/2023 të datës 21.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.786/2023 të datës 21.11.2023, në dispozitiv e ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit N.T.SH. “Magic Park”, me seli në Prishtinë, ndaj konkluzionit P.nr. 132/21 të datës 24.05.2021, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, si të pa lejuar.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa e debitorit në tërësi si e bazuar dhe të prishet aktvendimi KPPP.nr.786/2023 të datës 21.11.2023 si dhe të kthehet çështja përmbarimore përkatësisht Konkluzioni P.nr.132/21 të datës 24.05.2021 në rivendosje.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e debitorit dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.786/2023 të datës 21.11.2023, të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

*Ankesa e debitorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përmbartimore e përmbartuesit privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të : Kontratës mbi kredinë nr. 0066/08 e datës 28.08.2008, nr. 1573/09 e datës 09.11.2009, Kontrata mbi Hipotekën nr.0066/08 të datës 28.08.2008, Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. prot. 011-952-6-3009 të datës 28.08.2008, Kontratës mbi Hipotekën nr., 1573/09 të datës 09.01.2009, Kontratën mbi regjistrimin e Hipotekës nr. prot. 05-852-1023 të datës 03.12.2009, mbi borxhin total prej 59,002.82 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Me konkluzion E.nr. 68/12 të datës 29.01.2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, ka transferuar lëndën përmbartimore të lartë cekur pranë përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, kjo sipas zgjedhjes së kreditorit. Përmbartuesit privat Destan Bujupaj, me konkluzion P.nr.34/15 të datës 04.02.2015 ka marrë përmisiëpër që të veprojë si organe përmbartues në lëndën përmbartimore E.nr. 68/2012 të datës 29.01.2015 të pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe lënda në fjalë tani e tutje është udhëhequr me urdhërin P.nr.34/15.

Kundër propozimit për përmbartimin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përmbartuesit privat për arsye se urdhëri për përmbartim privat është në kundërshtim me dispozita e LPP-së për shkak se gjatë lëshimit të urdhëri përmbartuesi nuk është thirr në asnjë dispozitë konkretë.

Kreditorët brenda afat ligjore kanë paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar pretendimet e debitorëve, dhe duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorëve si i pa bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.786/2023 të datës 21.11.2023, në dispozitiv e ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit N.T.SH. “Magic Park”, me seli në Prishtinë, ndaj konkluzionit P.nr. 132/21 të datës 24.05.2021, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Isa Shala, si të pa lejuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye

se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përbarimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ka konstatuar drejtë faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar përbarimin ndaj debitorit mbi bazën e titullit ekzekutiv, dhe lënda fillimisht është udhëhequr me shenjën E.nr. 68/12 të datës 17.01.2012. Ndërsa sipas propozimit të kreditorit, lënda në fjalë është transferuar pranë Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, dhe lënda tutje është identifikuar me shenjën P.nr. 34/15 të datës 04.02.2015. Ndaj urdhrit në fjalë, debitori ka ushtruar mjetin juridik të prapësimit, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr. 317/15 të datës 20.07.2016 kishte refuzuar prapësimin si të bazuar, aktvendim ky i cili është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes aktvendimit Ac.nr.4786/16 të datës 12.07.2016. Në anën tjetër, pasi që urdhri për lejimin e përbarimit ka marrë formën e prerë, Përbaruesi Privat Destan Bujupaj është përjashtuar nga udhëheqja e kësaj lënde përbarimore, kjo sipas aktvendimit PPP.nr. 180/19 të datës 14.12.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ashtu që sipas propozimit të kreditorit, lënda në fjalë është transferuar tek Përbaruesi Privat Isa Shala, për të cilën rrethanë, Përbaruesi Privat i ka njoftuar palët përmes konkluzionit P.nr. 132/21 i datës 24.05.2021. Rrjedhimisht, bartja e lëndës përbarimore tek Përbaruesi Privat Isa Shala është bërë në fazën pasi që urdhri për lejimin e përbarimit ka marrë formën e prerë. Në këtë drejtim, fakti se lënda në fjalë është transferuar tek Përbaruesi Privat Isa Shala, dhe ka marrë shenjë të re P.nr. 132/21, nuk i jep të drejtë debitorit që të paraqes përsëri mjetin juridik të prapësimit, pasi që në rastin konkret, urdhri për lejimin e përbarimit P.nr. 34/15 i datës 04.02.2015 veçse ka marrë formën e prerë pas vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit, ndërsa konkluzioni i përbaruesit Privat Isa Shala me shenjën P.nr. 132/21, paraqet vetëm vazhdimësi të kësaj procedure përbarimore, e cila tanimë gjendet në fazën e ekzekutimit, dhe jo në fazën e shqyrtimit të lejimit të saj, ndërsa rezulton se Përbaruesi Privat Isa Shala, përveç nxjerrjes së konkluzionit P.nr. 132/21 të datës 24.05.2021 për njoftimin e palëve se lënda tanimë udhëhiqet pranë këtij Përbaruesi, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër procedural në këtë çështje përbarimore, konkretisht nuk ka nxjerrë urdhër plotësues lidhur me ndonjë kërkesë eventuale të kreditorit për zgjerim të përbarimit dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të ekzekutimit të përbarimit, pasi që vetëm në atë rast, debitorit NTSH "Magic Park" do t'i lejohej paraqitja e prapësimit edhe ndaj urdhrit përbarimor P.nr. 132/21, apo eventualisht ankesa ndaj parregullsive me rastin e kryerjes së përbarimit. Prandaj Gjykata shkallës së parë ka vlerësuar se prapësimi i debitorit i paraqitur me datën 03.06.2021 ndaj urdhëri P.nr. 132/21 është palejuar, kjo pasi që urdhëri në fjalë paraqet vazhdimësinë të Urdhëri Përbarimor P.nr.34/15 të datës 04.02.2015 i cili veçse ka marrë formën e prerë, sipas nenin 73 par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se : *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose të hudhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i pa lejuar”*.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar, mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit sa i përket asaj se për shkakë të ndryshimit të gjendjes faktike është domosdoshme që procedura përbarimore në këtë rast të zhvillohet prej fillim dhe pikërisht duke u bazuar me këtë aktgjykim të datës 10.03.2022.

Lidhur me pretendimet ankimore Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se asnjë nga pretendimet e debitorit nuk gjen mbështetje ligjore dhe se kemi të bëjmë me dokumente që janë të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së, mirëpo urdhëri përmbartimor ka marrë formën e prerë në kuptim të nenit 73 par. 3 të LPP-së.

Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me të gjitha pretendimet ankimore, gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se të njëjtat janë të pa bazuara. Me nenin 71 të LPP-së, janë paraparë shkaqet të cilat prapësimin e paraqitur ndaj aktvendimit për lejimin e përmbartimit do ta bënin të bazuar, andaj duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga arsyet e parapara në nenet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.199/24, me datë 08.08.2024**

**Gjyqtarin**  
**Faton Bajrami d.v.**